
DOKUMENTE E MATERIALE

I.

**Situata në Shqipëri dhe marrëdhëniet mes shqiptarëve
dhe xhonturqve sipas një raporti konfidencial të konsullit serb
në Cetinë, Jovan M. Jovanović të 9 majit të vitit 1908,
si edhe një letre të Ismail Qemalit të 1 korrikut 1908,
dërguar Eduard Greit në Londër**

Shqiptarët dhe Lëvizja Kombëtare Shqiptare (LKSH) në këtë periudhë ishin vënë para dilemës, të vazhdojnë të luftojnë kundër pushtetit absolut të sulltanit në drejtim të realizimit të kërkesave kombëtare, pavarësisht nga xhonturqit dhe lëvizja e tyre, e cila sa vinte e forcohej, posaçërisht në radhët e ushtrisë dhe policisë apo të ndihmojnë në rrezimin e pushtetit absolut të sulltanit dhe në kthimin e Kushtetutës së vitit 1878.

Shqiptarët dhe LKSH, pra ishin para një situatë të zgjedhjes mes sistemit absolut të sulltanit pa kurfarë të drejtash dhe lirish kombëtare, ose të zgjidhnin sistemin dhe programin e ri që ofronin xhonturqit. Shqiptarët, me shpresën se pas kthimit të Kushtetutës do t'i gëzonin të drejtat e tyre kombëtare, masivisht iu bashkangjiten Revolucionit Xhonturk dhe ishin nga bazamentet e tij.¹

Roli i shqiptarëve në fitoren e Revolucionit Xhonturk ishte vendimtar. Udhëheqësit e LKSH-së, posaçërisht ata të cilët vepronin jashtë Perëndorisë Osmane, në kolonitë shqiptare në SHBA, Romani, Egjipt, etj., i shikonin me shumë pesimizëm ngjarjet që ndodhnin në Perëndorinë Osmane. Gazeta e emigracionit shqiptar në Boston (SHBA) në një artikull me titull "Festoni" theksonte se nuk ishin xhonturqit ata të cilët e kthyen Kushtetutën, por shqiptarët dhe shtonte: "Si do të punojmë ne shqiptarët më tej kur Turqisë i dhamë një Kushtetutë ndërsa vetvetes një goditje të fortë".²

Shqiptarët e pranuan Revolucionin dhe kishin një shpresë të madhe te ai. Ata besonin se përfundimisht në Perëndorinë Osmane do të agonte liria. Ata besonin se pas kthimit të Kushtetutës secili komb, pa dallim feje, do të gëzonte të gjitha të drejtat nacionale dhe se do të kishte zhvillim të lirë nacional në kuadër të Perëndorisë Osmane.³

Zhvillimi i shpejtë ngjarjeve si duket i befasoi shtetet fqinje të Perëndorisë Osmane, të cilat në periudhën para Revolucionit kishin zhvilluar një propagandë të fuqishme në Perandori, posaçërisht në pjesën ballkanike të saj, edhe veçanërisht në Shqipëri dhe Maqedoni.

Propaganda serbe ishte e drejtuar posaçërisht në vilajetet e Shkodrës, Kosovës dhe Manastirit. Përfaqësitë e saj në këto troje gati çdo ditë dërgonin raporte në

¹ *DAM.MF* 1309, Raport i ambasadorit anglez Vilijam Erskin nga Roma deri te Eduard Grej, Ministër i punëve të Jashtme në Londër, Romë, 03.08.1908.

² *Kombi*, Boston, Mass., Nr. 98, 21.08.1908, "Pesimisti, Alfabeti i Gjuhës Shqipe dhe Kongresi i Manastirit", Tiranë, 1972, 207-209.

³ Muzafer Bislimi, *Shqiptarët dhe Revolucionit Xhonturk*, Shkup: 2008, f.265; po ai, *Albancite i Mladoturskata Revolucija*, Skopje: 2008, f.272.

Beograd, me të dhëna të detajuara deri në imtësirat më të vogla nga terreni, për aktivitetet e çetave të shkollave, instruksioneve, kërkesat etj.

I tillë është edhe ky raport i konsullit serb në Mal të Zi-Cetinë, Jovan M. Jovanoviq, i cili më 9 maj 1908 kishte filluar të shkruante këtë raport të detajuar dërguar Ministrisë së Jashtme Serbe në Beograd mbi situatën në Shqipërinë Veriore, për çka ai edhe vetë kishte udhëtuar në këto troje, pasi të gjitha planet ekspansioniste serbe parashihnin daljen e Serbisë në detin Adriatik përmes Shqipërisë, ndërtimin e një hekurudhe etj. Ai në këtë raport analizonte edhe propagandat tjera në këtë regjion të Shqipërisë, atë katolike, austro-hungareze, italiane si dhe qëndrimet osmane.

Ndërsa konsulli, pas kryerjes së udhëtimit, shkruante raportin përfundimtar, në Perëndorinë Osmane ndodhi Revolucioni Xhonturk dhe kthimi i Kushtetutës, kështu ai në fund të raportit u përqëndrua edhe në rolin e shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk dhe në përgjithësi rolin e shqiptarëve në Perëndorinë Osmane, pas Revolucionit, rol për të cilin ai ishte shumë i trembur.

Muzafer Bislimi

(Instituti për histori nacionale – Shkup)

Irfete Ibraimi

(Arkivi shtetëror i Maqedonisë – Shkup)

Konsulata serbe në Cetinë

Konfidencijale Nr.99

9 maj 1908

Zotëri Ministër,

**Kam nderin t'ju prezantoj këtë raport mbi aktivitetin tim
në Shkodër dhe rrethinë**

I. SHKODRA

Pas kthimit nga ceremonia në Bari(Tivari) u ndalova në Virpazar. Prej këtu me anijen Danica lundrova drejt Shkodrës. Anijet që lundrojnë nga Virpazari, Rijeka, Plavnica, Shkodra dhe Vraka, janë në pronë të shoqërive italizane "Kompania di Antivari", e cila po ndërton hekurudhën Bar-Virpazar dhe limanin në Bar. Këto anije dikur ishin pronë e shoqërisë angleze për lundrim nëpër liqenin e Shkodres (Anglo-Montenegrin Company LTD). Kështu tani në duart e italizanëve janë të gjitha rrugët të cilat përmes tokës, çojnë drejt Shkodrës. Në anijet përdoret edhe gjuha shqipe krahas asaj italiane.

Në 300 metra para doganës së Shkodres anija u ndal, dhe mua m'u desh të vazhdoj përmes tokës. Unë udhëtoja bashkë me të dërguarin turk në Cetinë, ndërsa në

* *DAM.MF.* 825. Arkivi Shtetëror Maqedonisë-Shkup, Raport i Konsullatës Serbe në Cetinë, 6547, PP, 77, "I", Red. 1610-1908.

doganën e Shkodrës na priti vali i Shkodrës, marshall Sejfulla Pasha, i cili më vonë më ndihmoi të realizoj udhëtimin tim.

Shkodra, shikuar nga jashtë është qytet i bukur, përplot me gjelbërim rreth tij, është një qytet për pushim e relaksim. Mbrenda, l si dhe në gjithë qytetet në Turqi, është i mbushur me qen të shumtë në numër, me pluhur, me rrugë të shtrembëra dhe të ngushta që mbërrinin deri rreth shtëpive dukatëshe me varre të vjetra muslimane me përmendore të rrënuara. Qyteti tregëtar i Shkodrës që sipas mendimit tonë e kanë ndërtuar Mërnjavçeviqët, sot paraqet një vendbanim turk. Kalaja është solide dhe një pikë e mirë strategjike, pasi dominon me shikim nga liqeni i Shkodrës dhe lumi Bojana(Buna) dhe Drini. Në hyrje të qytetit ka një mbishkrim të sulltan Mahmudit I, i cili shpreh admirim ndaj atyre që kishin zgjedhur këtë pikë strategjike për të ndërtuar këtë qytet. (“Fole të shkëlqyer ka zgjedhur shqiponja për të ruajtur zogjtë e saj”). Shkodra e vjetër disa herë ka ndryshuar pozitën e vet. Ajo shpesh ishte goditur nga tërmetet dhe vërshimet. (Prej aty do të jetë edhe thënja në këngët popullore se Shkodra nuk mund të ndërtohej në Bojanë nga vërshimet e lumit”). Kur binin tërmetet, atëherë qyteti ishte në fushë, por kur vinin ujërat atëhere kërkonin kodrina. Në vitin 1905 Shkodra u godit nga tërmeti dhe pësoi dëme të vogla. Më i goditur ishte qyteti i vjetër. Shkodra më shumë ka dëme nga përmbytjet . Lumejtë Kira dhe Drini, posaçërisht ne pranverë, kanë shumë ujë, posaçërisht Kiri i cili tani në maj është një prua i thjeshtë, por kur është i mbushur me ujë në pranverë në disa vende është i gjërë sa lumi Sava. Për ndërtimin e pendave dhe të shtrateve turqit kanë harxhuar shumë para, por sado që kanë bërë nuk kanë mundur ta mbrojnë qytetin nga vërshimet. Në qytet ka një urë te bukur romake me formë të bukur prej guri.

Mbeturinat e vjetra te qytetit nga koha romake tregojnë se ky qytet në Shqipërinë veriore duhet të ketë luajtur rol të rëndësishëm në tregëtinë romake në gadishullin ballkanik, posaçërisht në viset Danubiane, por dhe në aspektin ushtarak kishte rol shumë të madh. Në Shkodër ka shenja të cilat tregojnë se ajo ishte tregu kryesor ku tregtohej me mallra nga Sofja, Vidini, Nishi, Prizreni, Prishtina etj.

Shkodra e tashme nuk mund të krahasohet me asnjë qytet në bregdetin shqiptar. Në Shkodër duket sikur argëtim nuk ka fare ndërsa njerëzit duken tepër seriozë. Si ç’tregohet, shumë shkodranë janë të shpërndarë nëpër botë (Itali, Austri, Angli), pas tregtisë. Shkodranët e ruajnë traditën e tyre. Po të shohë njeriu veshjen mashkullore apo femrore, katolike apo muslimane, po të shohë mënyrën e të ecurit, të folurit, menjëherë do të dallojë shenjat e një race të shquar, të një kombi i cili rruan traditën e vet. Shkodranët duken njerëz më idilikë se kudo tjetër në Shqipëri. Mosmarrëveshjet fisnore dhe familjare këtu nuk janë të shprehura si në vende tjera. Në këta njerëz ka edhe veti të civilizimit, që shihen nga mobiljet shtëpiake, nga sjellja në shtëpi etj. Kjo situatë sigurisht ka ardhur si rezultat i sistemit shtetëror dhe ndikimit të fesë.

Shqiptarët shkodranë mbajnë në duart e tyre zejtarinë, tregtia në një pjesë të konsiderueshme mbahet përmes grekëve, vllahëve dhe, më se shumti nga italianët. Ka edhe dyqane zejtarë-tregtarë të shqipëtarëve dhe disa kafene të vërteta turke. Në Mal të Zi tregtarët dhe zejtarët më të mirë janë nga Shkodra. Në administratën e lartë dhe në ushtri, ka edhe turq. Mes tyre nuk ka shqiptarë nga Shkodra. Komuna e Shkodrës është në duar të shqipëtarëve, ndërsa në administratë ka edhe disa serbë nga Serbia e vjetër (Ashtu shteti serb e quante Kosovën në atë kohë, v.a.).

II. Propaganda katolike

Edhe pse në Shkodër hetohet diçka mes shqiptarëve, kur flitet për vetëdije politike nuk mund të thuhet se respektojnë ndonjë politikë. Nga kjo, propaganda e huaj është e vogël. Nëpër shkolla ç'ka bëhet dhe si bëhet realizohet nga Italia dhe Austro-Hungaria, pasi ato Shkodrën e konsiderojnë qendër të Shqipërisë veriore. E gjithë puna e tyre është e koncentruar në Shkodër, e cila për këto dy shtete konsiderohet si çelësi jo vetëm i Shqipërisë veriore, por edhe i asaj jugore. Nga kjo edhe lufta mes tyre në Shkodër është e ashpër.

Mënyra e konfrontimit dhe mjetet janë të ndryshme . Në njërin anë janë shkollat dhe kisha, ndërsa nga ana tjetër penetrimi tregtar.

Dy fuqitë e mëdha në Shqipërinë veriore posaçërisht në Shkodër, në qendër të vëmendjes kanë arsimin dhe katolicizmin . Feja është baza më e fortë e të gjitha synimeve dhe sepse edhe njëra edhe tjetra, ia kanë humbur misticitetin dhe qenien spirituale dhe e kanë shndërruar në mjet për përforcimin e mëtejshëm të ndikimit të tyre . Në këtë arsye shkollat katolike nuk janë fanatike të përlulur ndaj Austrisë si me parë. Muslimanët shkollorë me një fanatizëm të rrallë, e shohin sulltanin si të plot fuqishëm dhe besojnë në të si në Muhamedin. Shkollat katolike edhe sepse janë shqiptarë katolike, flasin për mirkuptimin dhe bashkimin e shqiptarëve në një Shqipëri të vetme e të pandarë.

Austria, sipas Marrëveshjeve ndërkombëtare të Karlovcit, Pozharevcit, Beogradit, Vienës më 1799 dhe 1855, ka të drejtë t'i mbrojë shqiptarët katolike në Shqipëri. Mbrojtja dhe protektorati i saj këtu shihet kudo. Në Shkodër ka një Peshkop dhe dy klerikë të lartë jezuitë dhe françeskanë. Jezuitët posedojnë mjete të mëdha, ndërsa françeskanët kanë më pak. Jezuitët shumica janë italianë nga Austro-Hungaria, ndërsa mes françeskanëve ka edhe shumë shqiptarë. Edhe pse fretrit janë italianë ata i mësojnë popullatës se feja katolike është një dhe se sunduesi më i drejtë është perandori Franc Jozefi. Atë nuk e bëjnë këtë nga shpirti, sepse janë italianë, por në të kundërtën do të humbnin vendet e punës dhe rrogat, që i marrin nga austriakët. Këtu, si në Maqedoni dhe në Serbinë e Vjetër, klerikët me postin e tyre mbajnë tërë familjen e tyre.

Jezuitët kanë vetëm një gjimnaz, një shkollë fillore me 180 nxënës dhe një shkollë teologjiko-tregtare me 69 nxënës. Në këto shkolla mësohet në gjuhën italiane, edhe atë e kryejnë shqiptarët katolike nga Durrësi, Shkodra, Zadrime dhe Kelmendi. Në to ligjëron edhe një hoxhë gjuhën turke, e cila ligjrohet edhe në shkollat tjera popullore në Serbinë e Vjetër dhe në Maqedoni. Përkundër këtyre, ka edhe një shkollë javore ku vijnë nxënës për të mësuar të dielave. Pastaj ka edhe një ent për varfanjakët, Shën Jozefi destinuar për fëmijët e katolikëve të varfër.

Françeskanët kanë shumë më pak mjete financiare se jezuitët, por shkollat e tyre, në të shumtën e rasteve, kanë shumë nxënës. Gjuha italiane nuk është më e detyrueshme në to kështu këto shkolla kanë kaluar në shqiptare.

Edhe motrat e mëshirueshme kanë shkollat e tyre. Murgeshat kanë shkollë me afër 280 nxënës, ndërsa ato nga rendi "Mandelele" kanë një shkollë të përzier me 300 nxënës.

Shkollat janë nën mbikqyrje të konsujve, disa edhe nën mbikqyrje të Ipeshkut. Në kohën e fundit është rritur interesi i zyrtarëve italianë për shkollat në Shkodër.

Italia për shkollat e këtushme harxhon mbi 60000 dinarë. Në Shkodër ka këto lloje të enteve- Një shtëpi bonjakësh me 168 fëmijë, një shkollë fillore me 200 nxënës, një shkollë fillore për femra me 170 vajza, një shkollë tregtaro-tekstilo-zejtare. Gjuha kryesore është italishtja ndërsa përdoret edhe shqipja si dytësore. Për nxënësit më të mirë egziston kolegji Shën Hadriani në Shën Demetrio në Itali, ku edukohen propagatorë të mirë, mësues dhe klerikë për në Shqipëri. Në Napoli egziston katedra për gjuhën Shqipe.

Shkolla shqipe nuk ka ndërsa Italia në Stamboll gjithnjë tenton të sigurojë irade të sulltanit me të cilën do t'u ndalohej myslimanëve të Perandorisë të frekuentonin shkollat e huaja. Përkundër kësaj Italia po afrohet edhe me Vatikanin për të përforcuar ndikimin e saj në Shqipëri.

Përkrah shkollave, propaganda italiane formon edhe spitale ambulatore. Spitalet, posaçërisht ambulatat, kanë së tepërmi punë edhe ate më shumë në propagandë. Qeveria italiane vëmendje të madhe u kushton shoqërive tregtare dhe posaçërisht i ndihmon ato të cilat punojnë për shkëputjen e lidhjeve të shqiptarëve me Austro-hungarinë. Më aktive është shoqata "Dante Aligieri".

Nga bisedat që pata me valiun dhe të tjerët për shkollat dhe suksesin e tyre, konstatova se asnjëra anë nuk ka arritur aq sukses, por shihet se nxënësit italianë kanë një përparim (në vitin 1900 nuk mund të bëhej fjalë për ente shkollore italiane në numër të tillë, ndërsa sot ka pesë). Propaganda austriake ka më pak efekte, pavarësisht mundësive dhe mjeteve që ka në dispozicion.

III. Austrija dhe Italia në Shkodër

Italia vëmendje të posaçme i ka kështuar ndikimit tregtar në Shqipëri. Këtë ma konfirmuan ata me të cilët kam biseduar, ndërsa më shumë një zyrtar austriak, i cili më dha të dhëna konkrete për këtë:

Sipas tij para disa viteve në Vienë nuk e merrnin në konsideratë ndikimin e Italisë në Shkodër, e cila është qendra më e madhe në Shqipërinë veriore, sepse aty shiten të gjitha produktet e fiseve, por edhe aty blihen të gjitha produktet e gatshme. Importi ynë ka qenë gjithmonë më i madhi në Shqipërinë veriore, prandaj ne kishim lënë jashtë dore portet e tjera. Por për dy-tre vitet e fundit Italia me importin e saj zuri vend të rëndësishëm dhe u kthye në konkurent serioz i yni. Në disa sektorë gati na ka larguar. Ja shembuj për Shqipërinë Jugore:

Viti 1900 ishte importuar nga Austro-Hungaria përmes Durrësit, Vlorës dhe Prevezës, mall me vlerë 2.035.000 din, ndërsa 1906 1.900.000.

Në vitin 1900, Italia në vilajetin e Janinës eksportoi mall me vlerë 438000 din., ndërsa më 1906, 2.896.000, pra për 5 vjet importi i tillë u zmadhua 7 herë ndërsa i yni është zvogluar. Numri i anijeve Austriake që kanë hyrë në Durrës, Vlorë dhe Prevezë në vitin 1901 ishte si vijon: Durrës 175, Vlorë 151 dhe Prevezë 104. Për këtë vit anijet italiane ishin këto: Durrës 59, Vlorë 51, Prevezë 50. Pas tre viteve, më 1904, situata është kjo: anije austriake në Durrës 209, Vlorë 224 dhe Prevezë 101. Italijane: në Durrës 108, Vlorë 181 dhe Prevezë 103. Të shohim si janë punët në Shkodër. Këtu më 1904 Austria eksportoi 33700 cent meterik mall, ndërsa vetëm në 1907 - 48896 cent meterik, italijanët në vitin 1904 eksportuan 19610 cent meterik, ndërsa në vitin 1907, 35462 cent meterik, për 56% më tepër se në vitin 1904.

Pra, si sqarohet përparimi italian në Shqipëri ?

Me punë te menduar dhe të organizuar mirë me plane dhe qëllime konkrete. Italia organizoi lundrim të mirë për anijet e saj, hap agjensi tregtare, dërgon agjentë tregtarë, konsuj etj. Por më së shumti ka rregulluar komunikacionin detar. Më 1893 mes Italisë dhe Shqipërisë nuk kisht gati kurrfarë shkëmbimi. Kishte një anije prej Venediku drejt Shqipërisë, çdo 15 ditë. Në vitin 1898, kishte një linjë Bari –Prevezë. Në vitin 1901 kishte anije prej Venediku drejt Shqipërisë një herë në javë. Po të njejtin vit kishte filluar linja San Gjovani (Shëngjin) Dime Dua - Obot dhe Bunë, ndërsa vitin e ardhshëm lundrimi është zmadhuar për dy herë. Më 1904 këmbimi është dyfishuar në të gjitha hekurudhat. Sot nga Venediku nisen anije drejt bregut shqiptar tri herë në ditë, deri te portet më të rëndësishme. Prej Ankonës, Barit, Brindizit drejt Vlorës, Prevezës dhe Durrësit . Qeveria italiane për këto punë jep subvencione 500 000 lira. Ja si është situata me anijet tona që mbartin mallra. Më 1901 ato mbartnin mbi 46 % të mallit, ndërsa ato italijshe vetëm 14 %, më 1904 anijet tona (austro-hungareze v.a.) mbartnin 9% ndërsa ato italijshe 58% të mallrave. Çdo ditë përqindja e italianëve rritet. Për Shkodrën të dhënat janë kështu: Më 1903 anijet austriake importuan 37000 centë meterik mall, ndërsa ato italijshe rreth 15000 centë meterik mall. Më 1905 anijet austriake kanë mbartur 16000 centë meterik mall ndërsa ato italijshe 38000 centë meterik mall. Ja pra si qendrojnë punët. Në tregun e Shkodrës, edhe përkundër kësaj, ne qëndrojmë mirë por nuk është kështu në pjesët e tjera të Shqipërisë. Edhe në Shkodër nuk dimë se sa do të zgjasë kështu, si shkojnë punët duket se nuk do zgjasë shumë. Si duket Italia definitivisht do të na shtyjë prej këndeje. Ata në Vjenë e dinë se është në interesin më të madh të mbahet Shkodra dhe Shqipëria Veriore, por si duket makineria burokratike austriake po lëviz shumë ngadalshëm ndërsa ajo italiane shumë më shpejt.

Përveç shërbimit të lundrimit dhe komunikacionit tregtar, italianët kanë hyrë edhe në qarkullimin postal në Shkodër. Nga kudo prej këtu, përmes Bunës apo liqenit të Shkodrës, qeveria italiane subvencionon transportin mes Barit dhe Virpazarit me 35000 lira. Si ç'thashë më lart lundrimi në liqenin e Shkodrës është në duart e italianëve (Compania di Antivari). Anijet e kësaj shoqërie rregullisht mbajnë linjat mes Shkodrës dhe Adriatikut, ndërsa anijet austriake shumë rallë vijnë deri në Obod, aq më shumë që anija "Firenca" vjen gati deri në qytetin e Shkodrës. Pasi Italia fitoi të drejta speciale në qarkullimin postal, që i kanë edhe Fuqitë e tjera të mëdha, qarkullimi postal është përmisuar dhe organizuar më mirë. Pulla postale që përdoret në postën italiane në Shkodër është e njehta me atë që përdoret në postat mbretrore italijshe, vetëm se këtu me shkronja të mëdha nën portretin e mbretit Italian, shënon "Shqipëria", sikur Shqipëria të ishte koloni italiane, ndërsa [nuk vihet re] asnjë gjurmë nga Turqia.

Në një raport timin për Barin dhe portin e tij më duket se krejt historiku i tij është italijshe. Ky syzozim i imi konfirmohet edhe nga i dërguari rus në Shkodër, ndërsa më vonë edhe nga Sejfullah Pasha, kur me të bisedova për situatën në këtë vilajet.

I dërguari rus ma sqaronte kështu situatën e propagandës italijshe në Shkodër:

"Austriakët janë më të vjetër, kanë bërë shumë për të sunduar këto teritore. Kur italijshe erdhën këtu të punonin, ata i përqeshnin dhe mendonin se nuk do të arrijnë sukses; por u gënjyen të gjithë. Italijshe kishin zhvilluar një aktivitet sistematik nëpër tërë Shqipërinë. Kolegu francez ka të dhëna më të mira për udhëtimin e tyre, zmadhimin e tregtisë, ndërsa në Shkodër nuk mund të hiqet përshtypja nga ajo që ata bëjnë këtu. Ata njëherë angazhohen që të pengojnë austriakët në Shqipërinë veriore, ta marrin Shkodrën, e cila nëse nuk është çelësi i Shqipërisë, është bazë e fortë për punën e tyre,

po të mos e kishin atë nuk do mund të bënin asgjë në Shqipëri. Për këtë italianëve u ishin të mirseardhura lidhjet fafësorore me Malin e Zi. E dini me çfarë plani punon Italia në Shkodër. Së pari prishën monopolin e duhanit në Mal të Zi dhe fabrikën kryesore të duhanit e ndërtuan në kufirin mes Malit të Zi dhe Shqipërisë në Podgoricë. Shoqëria Monopolistike është në duart e shoqatës venedikase (sekretar i së cilës është konsulli i nderit serb në Venedik) dhe është nën protektoratin e qeverisë italiane. Për vendosjen e Monopolit thuhet se janë dhënë para të mëdha. Pas Monopolit ka ardhur lundrimi nëpër liqenin e Shkodrës nga Rijeka Crnojeviqa deri në Shkodër, me anije. Lundrimi është vetëm në duart e tyre. Pas kësaj erdhi ndërtimi i hekurudhës së ngushtë nga Bari deri në Virpazar dhe liqen të Shkodrës. Dhe, në fund, erdhi edhe ndërtimi i portit në Antivari (Bar). Këto janë ato drejtime të cilat kanë një karakter të pastër ndihmës, pasi, më besoni, ato nuk sjellin kurfarë profiti por vetëm humbje. Por për përfitim të Shqipërisë duhet të hidhen disa miliona në “Nostre Mare”. Por kjo do u paguhet. Italianët do ndërmarrin rregullimin e Bunës dhe tharrjen e moçaleve përreth liqenit të Shkodrës, por [duket] sikur edhe austriakët po fillojnë të zgjohen...”

Ky fjalim mua më kujton një fjalim të ngjajshëm të konsullit rus në Cetinë, i cili në një rast pat thënë:

“Si e shihni, rusët që kanë harxhuar shumë para për Malin e Zi për ato vite nuk kanë mundur të gjejnë disa miliona t’i hedhnin në det dhe të kishin gjithçka në duart e tyre. Ne me shekuj vetëm bënim pengesa për depërtimin katolik, ndërsa krijuam fortesë për ta.

Në vend të një armiku të sllavizmit kemi fituar një tjetër, më të keq dhe më tinzak...”

Dhe vetëm për atë që Rusia e fortë nuk gjetidisa miliona t’i hidhte [këtu], ndërsa hodhi miliarda në Lindjen e Largët...”

Kur bisedova me Valiun e Shkodrës, mareshalin Sejfullah Pasha, ai më konfirmoi gjithçka që u tha më lart për propagandën italiane dhe austriake.

“Ne shohim – tha ai se çka punojnë ata. Italianët janë më të suksesshëm, më të mençur dhe më të fortë, dëshirojnë gjithkund të veprojnë sipas ligjit dhe të arrijnë të përfitojnë diçka. Dhe për atë fitojnë më shumë se austriakët, të cilët janë pak më koprracë dhe më kryelartë.. Unë nuk jam moti këtu por shoh se ndikimi i tyre këtu është i kotë. Megjithatë ata duan të lidhen me udhëheqsit e këtyre shqiptarëve të egër, me ta bëjnë tregti, blejnë pyje, miniera etj. Bëjnë punë. Përfitojnë dhe kryejnë propagandë shumë të rrezikshme. Përfitojnë toka.”.

Austriakët kanë kontakte të mira me udhëheqsit e malësorëve si Mirditët, Kelmendët, Hotët, Kastratët etj. Për këtë kanë dijeni edhe në Stamboll, por edhe pashallarët dhe veziri i madh kanë lidhje me to. Ne shohim gjithë këtë dhe nuk ndërmarrim asgjë. Ne këtu jemi të pafuqishëm. Këtu thotë është në pyetje tradita. Këtu unë jam vali, por udhëheqësit shqiptarë kanë shumë të drejta. Kur të vijë koha do të më ndërrojnë si paraardhësin tim. Ata kanë komandantin e xhandarmërisë së vilajetit, të cilit unë asgjë nuk mund t’i bëj ndërsa, të kundërtën, ai mua mundët çdo gjë të më bëj. Duhet ti ndjek në brendësi të vendit, por edhe aty nuk mundem aq fort. Në vilajet nuk ka ligj, nuk paguhen tatime dhe nuk bëhet rekrutim me rregull për në ushtri. Kjo ushtri e vogël rreth meje është gjithçka, por edhe kjo ushtri në këto treva po solidarizohet me shqiptarët. Sikur të mos më kishin sjellë këtu nga Manastiri.

Komandanti i xhandarmerisë së vilajetit Esat Pasha, shqiptar nga Tirana, pasanik dhe nëpunës grabitqar, ka shumë ndikim nga Shkodra deri në Durrës, por edhe në gjithë Shqipërinë. Është pronar i pronave të pafundëta, pyjeve dhe çifligut më të pasur në Shqipërinë Veriore. Është mik i madh i italianëve. Kur njëherë bisedova me të pas një drake në shtëpinë e tij të pasur të stolisur me stil lindor, morra përshtypjen se ai don dhe natyrisht do tu përmbahet ideve përparimtare, ndërtim të rrugëve, hapje të tregjeve, forcimin e ekonomisë të shqiptarët, ndërsa italianët e ndihmonin. Këtë ata e bënin në mënyrë shumë të mençur në Shqipëri. Si më thanë të tjerët, ai veç kishte shitur pjesë nga pyjet e tija, blen miniera dhe pastaj për pak para ua shet fsheturazi konçesionerëve të huaj. Disa e konsiderojnë si njeri të italianëve, ndërsa mua ende në veshë më tingëllojnë fjalët e tija në një frengjishte të keqe “ Autriche pas amie nous...Italieni meme rarra....meme e arra...”. I vetmi i cili më ka folur kundër aktivitetit italian këtu ishte konsulli malazes. Edhe te ai si dhe në Cetinë, mësova se te malazetët ka më shumë disponim ndaj Italisë se sa ndaj Austrisë. A është kjo sepse italianët në Mal të Zi kishin dy tri pozita prej të cilave vështirë se mund të nxirren? A do të përparojnë italianët këtu? Vështirë është të thuhet.

Shqipëtarët e këtushëm janë të ndarë në dy pjesë dhe në dy fe: në shkollë mësojnë se ka dy perandorë, njëri në Vjenë dhe tjetri në Stamboll, si edhe të mos respektojnë një komb shqiptar. Paratë e kryejnë funksionin e njejtë si në Maqedoni. Austria ka një ndikim të madh te malësorët e rrethinës së Shkodrës.

Italia punon më pak, shpejt, në mënyrë energjike por të pa caktuar, janë zgjeruar shumë dhe nuk e njohin mir terrenin . Turqit nuk punojnë asgjë dhe nuk mund të bëjnë asgjë për shkak të marrëdhënieve të brendshme dhe sjelljes së tyre ndaj shqiptarëve. Tereni për veprim është shumë i përshtatshëm.

IV. Serbët në Shkodër

Për këtë, për fat të keq nuk kam shumë ç'ka të shkruaj. Serbët në Shkodër janë 200 shtëpi ose rreth 1200 banorë edhe ata nuk janë të gjithë vendas: ka ardhacakë nga Mali i Zi, Struga, Ohri, aty llogariten në përgjithësi të gjithë nga Maqedonia. Ata kanë zanate në duart e tyre si: bukëpjekës, muratorë, ashxhinjë, etj. Shumica e tyre janë të varfër. Ata kanë një shkollë fillore, një kishë të vogël dhe një copë komune. Shkolla është katër klasë mashkullore dhe femërore ku ka edhe një foshnjore për fëmijë. Në shkollën femërore më shumë mësohet puna femërore e dorës, ndërsa në ato mashkullore kanë programin e shkollave tona. Kanë dy mësues dhe dy mësuese, prej të cilave njëra nuk din serbisht ndërsa njëri mësues është vllah. Fëmijët, rreth 60, mësojnë mirë, vetëm mënyra është e vjetëruar, sistemi papagall. Shkolla është e ndërtuar nga Boroviqët, prej të cilëve i fundit kishte vdekur para ardhjes time në Shkodër. Kisha ka dy klerikë, prej të cilëve njëri është xhakon. Serbët këtu janë në mosmarrëveshje: kjo është mosmarrëveshje e vjetër ende e parregulluar. Shkas për konfliktin mes dy familjeve Boroviq dhe Popoviq ka qenë një ndodhi . Vajza e njërit, më ka treguar konsulli rus, ishte martuar me një nëpunës të konsullit rus . Kjo grua ishte preteksti, ndërsa shkak ishin marrëdhëniet ose ndodhitë në një shtet tjetër. Urrejtja u zgjerua edhe në shkollë edhe në kishë . Mitropoliti ynë, jo vetëm që nuk ishte në gjendje që këto mosmarrëveshje ta rregullonte por ai nuk mundi që ortodoksët në Shkodër t'i bashkonte nga kisha ortodokse greke . Konsulli grek në Shkodër edhe sot nuk shkon në kishë për

shkak të këtyre ndodhive, por me pak vullnet kjo punë mund të zgjidhet. Mosmarrveshjet sot nuk duhet të jenë në plan të parë.

Mësuesit dhe klerikët paguhën nga Mali i Zi. Paria Lazar Mijushkoviç është udhëheqës.

Në raportet e mia nga Cetina kam informuar disa herë se në Mal të Zi duke filluar nga Kral Nikolla deri te serdarët e tij, të shkolluar dhe të pashkolluar, kundërshtojnë që hekurudha nga Danubi të dalë në bregdetin turk (bregdetin shqiptart v.a.). Ata aq janë kundër sa mbreti edhe tash punon kundër këtij projekti në Stamboll dhe Petrograd.

Valiu në Shkodër më tha se kjo hekurudhë nga shqiptarët e Shkodrës dhe Shqipërisë Veriore do të pranohej me gjithë dëshirë. Shqiptarët do të punonin si u urdhërohej. Ata ende nuk e kuptojnë rëndësinë e hekurudhës. Kur e pyeta se a është e vërtetë se ata rebelohen kundër hekurudhës, ai mu përgjigj se kjo nuk është e vërtetë. Ai më tha se luftimet që kanë ndodhur te Ura e Vezirit afër Prizrenit nuk kanë lidhje me hekurudhën dhe se lajmet e tilla janë pjesë e propagandaës malazeze.

Turqit më shumë janë që hekurudha të dalë më në jug, për shembull në Durrës dhe asesi nuk do pranonin që ajo të dilte në Bar dhe, aq më pak, që ajo ta anashkalojë Shkodrën si qendër të rëndësishme të tyre. Disa udhëheqës turq këtë e shohin si mënyrë për përforsimin e pushtetit turk në Shqipëri.

Edhe Esat Pasha është për atë që hekurudha të dale në Durrës dhe në këtë qëndrim ndoshta më shumë motivohet nga shkaqe personale, ashtu së paku më duket mua.

Gjatë bisedës me një shkodran të vjetër mysliman, ai më tha se ne nuk kemi asfarë dobi nga ato hekura, ajo do të na prangosë dhe vetëm do të na zenë frymën.

Shqiptarët dhe Xhonturqit

Unë nuk e di se si do të zhvillohen ngjarjet në Turqi, por që në të ardhmen shqiptarët do të luajnë rol të rëndësishëm është më se e sigurt. Kjo mund të shihet edhe nga mënyra se si shqiptarët e pranuan Kushtetutën dhe situatën e re në Turqi.

Në Shqipërinë Jugore shqiptarët masivisht përkrahin Kushtetutën. Vetëm mitropolitin grek në Vlorë kishte refuzuar të betohej në Kushtetutën.

Tendencat xhonturke dallohen nga ato të shqiptarëve. Ata duan ta përforcojnë pushtetin e tyre dhe të islamit, ndërsa shqiptarët duan ta ruajnë kombësinë e tyre nga ndikimet e huaja, posaçërisht nga propaganda sllave dhe greke. Shqiptarët, pa marrë parasysh a janë mysliman, ortodoks apo katolikë, nuk bëjnë dhe nuk duan të bëjnë kurrfarë dallimi në kërkesat për të drejtat e tyre respektivisht ata duan liri të predikimit fetar të të gjitha feve. Duhet të theksohet se shqiptarët janë elementi më fanatik fetar, të fortë dhe të pathyeshëm, i cili nuk duron kufizime të vendosura nga qeveritë e padrejta, përparim dhe zhvillim në arsim dhe ekonomi. Udhëheqësit shqiptarë jashtë nuk janë as grekë, as bullgarë as serbë e as turq, por shqiptarë që dëshirojnë të jenë vetë zotër të fatit dhe vendit të tyre. Ose tërë programi i tyre mund të përkufizohet në një: “Shqipëria e shqipëtarëve nën sovranitetin e Perëndorisë Osmane”.

Do të përmend një deklaratë karakteristike të Dervish Himës, redaktorit të gazetës “Albania” të Brukselit, me prejardhja nga Ohri, që e dha tani afër për serbët dhe Serbinë:

“Shqiptarët tash do të formojnë një parti popullore me shqiptarë nga të tre religjionet, e cila do ta koordinojë punën e komiteteve shqiptare të brendshme dhe të

jashtme, me qëllim ngritjen e vetëdijes kombëtare dhe për përfitimin e të drejtave të përcaktuara. Për tash do të bëjë aktivitetin më të madh gjat zgjedhjeve. Deputetët e zgjedhur shqiptarë, të cilët do të mbledhen në Parlament, do të parashtrajnë kërkesat e Shqiptarëve. Nëse kërkesat e tyre nuk plotsohen, atëherë ata do të jenë opozita më radikale....”

Numri i serbëve në të quajturën “Serbi e vjetër” (Kosovë, v.a.) është shumë i vogël dhe serbët në shekullin e XIX janë koncentruar në Lindje dhe Perëndim. Lëvizja serbe në Vilajetin e Kosovës është e përkrahur nga Mbretëria Serbe përmes shkollave dhe çetave, të cilat kanë për detyrë të thyejnë Lëvizjen Kombëtare Shqiptare.

Ndërtimi i hekurudhës austro-hungareze përmes Sanxhakut, shqiptarët do të duhej ta përshëndetnin pasi me të do të ngrihej fuqia ekonomike dhe prandaj kjo hekurudhë është mjeti më i mirë që të pengohet aktiviteti i përbashkët serbo-malazez kundër Shqipërisë....

**Zotit Ministër
Me respekt,
Jovan M. Jovanović**

* * *

**LETËR E ISMAIL QEMAL BEUT DËRGUAR SIR EDVARD GREJ
(PRANUAR MË 3 KORRIK)⁴**

Londër, Hotel Cecil, 01 korrik, 1908

(Konfidenciale)

Ekselencë,

Kam ardhur në Londër me një dëshirë të vetme, ta njohtoj Ekselencën tuaj për esencën-thelbin e çështjes së Hekurudhës Danub-Adriatik, çështje që i intereson gjithë gadishullit Ballkanik, posaçërisht mëmëdheut tim Shqipërisë.

Më lejoni që Ekselencës suaj tu dorëzoj një notë për sa i përket kësaj çështje dhe do të jem shumë i lumtur të kem nderin të pranoem personalisht, që të sqaroj edhe gojarisht opinionet e mia për këtë dhe gjithashtu për çështjen e Maqedonisë.

Nënshkruar: Ismail Qemal Beu⁵

⁴ *Arkivi i Maqedonisë, AM.MF.* 1275, Letër e Ismail bej Qemalit dërguar ser Edward Grey, Ministër i punëve të Jashtme i Anglisë. Arkivi burimor: Public Record Office 862, Foreign Office 371 537, London, 1.07.1908, Originali i letrës është në gjuhën frënge.

⁵ Në vllugun e turbulencave të mëdha në Perandorinë Osmane në vitin 1908, si edhe në kohën kur Austro-Hungaria kishte filluar realizimin konkret të hekurudhës Uvac-Mitrovicë, duke u përballur me një rezistencë të madhe të shqiptarëve të Vilajetit të Kosovës nga njëra anë dhe me një fushatë të madhe diplomatike të Serbisë, e cila nga ana saj insistonte në planin e saj për

Notë mbi Hekurudhat Ballkanike

Çështja e hekurudhave ballkanike kërkon një qasje dhe vëmendje ndaj rrezikut të ekspansionizmit gjerman, nga ana e Fuqive Perëndimore, për egzistencën nacionale të shteteve ballkanike dhe për ardhmërinë e Turqisë. Është më se e sigurtë se Gjermania po e drejton vëmendjen kah Lindja dhe kërkon që të shfrytëzojë hekurudhat për ndërmarrjen dhe zhvillimin e iniciativës së saj.

Gjermania gjithë këtë e bën në interes të influenceës së saj përmes aksioneve politike dhe ekonomike të Austro-Hungarisë. Ajo njëkohësisht po shfrytëzon relacionet miqësore dhe falenderimin që ua shprehu sulltani për ndryshimin e qëndrimit të tyre neutral, të cilën sulltani me kokëfortësi e konsideron si përkrahje të tij për rregullimin e çështjeve të ndryshme Orientale.

Në të gjitha rastet, Austria është bashkëpunëtorja më e mirë dhe më e sigurtë e Gjermanisë dhe e gjithë kjo ofensivë nga ana e saj nuk është gjë tjetër veç një fenomen i politikës së përgjithshme Gjermane.

Austria, pra, të cilën duhet ta konsiderojmë si avangardë të Gjermanisë, duke u nisur nga fakti se pozita e saj është forcuar me okupimin e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe nga dobitë e tjera për të dalë nga Konferenca e Berlinit, ka përgatitur zhvillimin e politikës së saj dhe të shtimit të influencës ekonomike në Ballkan. Deklarata e Baronit Erental dhe negociatat që pasuan, hodhën një dritë të re në këtë politikë të qetë por të fortë.

Me projektin e saj për lidhjen e rrjetit boshnjak me atë turk, Austria kërkon, jo vetëm të sigurojë një dalje të dyfishtë në Selanik por njëkohësisht të krijojë një vijë penetrimi, e cila do të jetë nën influenceën e saj, duke mos kaluar nëpër asnjë shtet të pavarur ballkanik, as nëpër Hungari, dhe don të ndajë kështu interesat e saja ekonomike dhe sistemin e hekurudhave me ato të Cisletanisë. Ndërtimi i kësaj hekurudhe nëpër territorin kroat dhe mosmarëveshjet me Hungarinë, që para shumë kohësh, janë prezente dhe do të kenë për rezultat disbalancimin politik dhe ekonomik të shteteve të Kurorës së Sent Etienit, duke i marrë Hungarisë të vetmin shtet përmes të cilit ajo ka dalje në

hekurudhën Danub-Adriatik, patrioti dhe aktivisti i njohur i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Ismail Qemali, si dhe gjithë shqiptarët në atë kohë ishte i brengosur thellë nga zhvillimi i tillë i ngjarjeve. Për këtë arsye, ai vendosi të udhëtonte në Angli dhe ta njoftonte personalisht ministrin e jashtëm britanik Edvard Grein dhe t'i elaboronte atij të gjitha këto projekte ndërtimore dhe qëllimet e fundit të këtyre projekteve të shteteve fqinje ballkanike, të cilat parashikonin të gjitha kalimin nëpër territoret shqiptare. Ai dëshironte të njoftonte ministrin Edvard Grej, edhe për idenë e tij për një projekt, të hekurudhës Ballkanike, siç e quante vetë ai. Ai jo rastësisht udhëtoi drejt Londrës. Nga të gjitha Fuqitë e Mëdha vetëm Anglia mbahej neutrale ndaj këtyre dy projekteve, austriak dhe serb. Kjo shihej qartë edhe nga Memorandumi i Forin Ofisit, i dërguar deri te qeveria serbe, pas kërkesës së këtyre për përkrahjen e projektit të tyre, ku shihej qartë se Anglia nuk përkrahte asnjërin prej këtyre projekteve. (AM.MF.1275, Memorandum i Forin Ofisit qeverisë serbe, Londër, 21.02.1908). Kështu ai deshi që të shfrytëzonte këtë qëndrim anglez dhe t'u tregonte atyre për anët negative të këtyre dy projekteve, duke prezantuar njëkohësisht projektin e tij për një linjë hekurudhore, e cila do të lidhte Vlorën me Manastirin, me tendencë për lidhje të mëtutjeshme edhe me qendrat e tjera ballkanike. Ai u vendos në hotelin Sesil në Londër, ku edhe shkroi këtë letër më 1 korrik 1908, duke kërkuar takim me ministrin e jashtëm anglez Edvard Grej. Ne nuk kemi të dhëna nëse ai, përveç që dorëzoi letrën, ka bërë takim ose jo me ministrin Edvard Grej.

Adriatik. Në të njejtën kohë, Austria dëshiron të kompletojë sistemin e rrejtë hekurudhor oriental në mënyrën që asaj do t'i sigurojë përfitime komerciale njësoj si Gjermanisë, monopolin e trafikut në shtetet ballkanike, duke protezhuar një komunikim direkt nga Viena dhe gjithë Gjermania me Selanikun dhe eventualisht me Pirenë, dy portet më të afërta të Kanalit të Suezit, për tu lidhur më trafikun e shteteve Lindore, jo vetëm me Levantin, por gjithashtu me shtetet e Lindjes së largët.

Neni 25 i Marrëveshjes së Berlinit i marrë nga letra dhe isqaruar nga paragrafi i fundit i nenit 29 i të njejtës Marrëveshje, nuk lejon interpretim të gjerë, i jep të cilin kabineti i Vienës dhe në të cilin ai bazon të drejtën për të ndërtuar dhe poseduar pjesën që duhet ndërtuar prej Uvaci në Mitrovicë. Gjithnjë ata nuk nisen drejt realizimit të projektit të lidhjes, duke mos cënuar interesat ekonomike të provincave europiane Turke dhe pa cënuar shpirtin liberal, i cili duhet të predominojë për sa i përket zhvillimit dhe ndërtimit të vijave hekurudhore internacionale.

Fuqitë e Mëdha Perëndimore nuk duhet të sjellin pengesa në zhvillimin e mjeteve të komunikimit mes Lindjes dhe Perëndimit, por ato duhet të angazhohen për pengimin e eksploatimit ekonomik të gadishullit ballkanik nga Austria dhe Gjermania, gjë që përbën një rrezik të madh. Duhet pra që ti sigurohet bllokut ballkanik njëkohësisht pavarësia politike, lirshmëria e komunikimit dhe të evitohet ajo që vijat hekurudhore të ndërtohen duke falenderuar njerën apo tjetrën fuqi të madhe, që një entitet të favorizohet në dëm të tjetrit. Në këtë mënyrë, e patjetër duhet që të formohet në gadishullin Ballkanik një rrejt, i cili do të ndërtohej në atë mënyrë që të përfaqsonte jo vetëm barazinë mes entiteve, por njëkohësisht të ishte edhe mbrojtje ndaj predominimit të njëjës Fuqi ose grupi Fuqish, duke dhënë mjete komunikimi të lira me shtetet e tjera. Gjithashtu duhet formuar një qarkullim komercial me një sens vertikalisht nga qarkullimi Austro-Gjerman; ky qëllim nuk duhet të frikësojë askend pasi do të ndërtohej një rrugë, e cila nga veriu do të dilte në Adriatik.

Si kundërbalancim të projektit Austriak, Serbia, e përkrahur nga Rusia, ka propozuar një projekt, të quajtur vija Danub-Adriatik, e cila duhet të realizohet duke përfunduar në Sen Xhovani di Medua (Shëngjin – M.B.) apo Tivar. Kjo hekurudhë, e cila qartë ka një interes relativ, nuk plotëson asnjë nga nevojat që do ti paraqesim. Këtij projekti ne do ti paraqesim një kundërprojekt tjetër, ndërtimin e një vije hekurudhore, e cila do të nisej nga Vlora për t'u lidhur me Manastirin; kjo trase ka epërsi të pakontestueshme, si për regjionin ashtu edhe për Fuqitë Perëndimore, sikurse ne do të sqarojmë.

Pikë së pari projekti serbo-rus, Danub-Adriatik, do të krijonte një linjë ekcentrike e cila do të lidhte vetëm një pjesë të gadishullit Ballkanik; kjo posaçërisht ka të bëjë me Serbinë, e cila do të përfitonte shumë beneficione në kuriz të popujve ballkanas, dhe do t'i kundërvihej posaçërisht hekurudhës Gjermane, që do t'i cënonte interesat e shteteve ballkanike dhe interesat e përgjithshme të Shteteve Perëndimore.

Linja gjithnjë do të konsiderohej dhe do të ishte e varshme nga sistemi Austriak i hekurudhave. Në të njejtën kohë do të ishte një servis i interesave Sllave dhe si, i tillë, do të ngjallë dyshimet të popujt e tjerë ballkanikë, gjithashtu do të shkaktonte kundërshtime dhe kryengritje të shqiptarëve.

Konsiderata e parë do të ishte se konstruimi i kësaj hekurudhe është një favorizim i ri për sllavët. Shqiptarët, pasi kundërshtuan me forcë ndikimin nga pala austriake⁶, e konsiderojnë këtë linjë me plot të drejtë, si projekt për shkatërrimin e tyre. Territori i tyre do të grimcohej dhe këtë e përjetojnë si sulm mbi integritetin nacional. Nga ana e tyre do të ketë një rezistencë të fortë që nënkupton një zjarr i cili do të kaplojë edhe Maqedoninë nga veriu dhe perëndimi, dhe kjo do të shkaktojë një thellim edhe më të madh të krizës së tashme. Nga ana tjetër regjioni i përshkruar nuk është aq i gjerë dhe i pasur për të siguruar për hekurudhën një projekt produktiv. Më në fund, Sent Xhovani di Medua, porti i përmendur më shumë paraqet një port të [kategorisë- MB] së fundit, në një gjendje të vështirë dhe duhen shumë investime të shtrenjta që ai të bëhet një port detar, për komunikacion të madh. E njëjta gjë është pak a shumë edhe për Tivarin.

Përkundër kësaj, vija Vlorë-Manastir, që ne propozojmë përballë propozimit serb, i përbush të gjitha kërkesat dhe është i realizueshëm më lehtë.

Porti detar i vijës hekurudhore që ne propozojmë, Vlora, është një port i shkëlqyeshëm, i vendosur në një pozitë të volitshme në Kanalin e Otrantos, në pikën e bashkimit të Detit Jon dhe detit Adriatik, shumë afër nga ana tjetër me Italinë, që nuk i ndan një distancë më e madhe se ajo mes Doverit dhe Ostendes.⁷ I vendosur në qendër të bregut Greko-Shqipëtar, i vendosur në një gjë të thellë dhe të qetë, prej ku shumë lehtë mund të lundrohet në detin Adriatik, detin Jon dhe pastaj në Mediteran, duke dalë nga një regjion i pasur i rrethuar me një fushë të pasur, Vlora paraqet një port detar të nevojshëm për linjën ballkanike.

Duke u nisur nga Vlora linja hekurudhore do të pasonte trasenë që vijon: Ultësirën e Myzeqesë, fushën e Devollit, rrafshnaltën e Korçës, Florinën, dhe Manastirin (ku bashkangjitet me linjën egzistuese Selanik-Manastir); nga Florina apo Manastiri mund të kalohet përmes fushës Karasu, apo asaj të Prilepit dhe të lidhet me linjën egzistuese Shkup-Selanik. Në Karaferi do të takohet me linjën që lidhet me hekurudhat greke, që vijnë nga Larisa përmes Serfixhes apo Platamonës dhe fushës së Bistricës.

Pas bashkimit me linjën në Shkup, vija bashkohet me linjën egzistuese, që kalon nëpër teritorin serb, shkon në Nish (aty lidhet me hekurudhën ndërkombëtare Beograd-Sofje-Stamboll). Një krah i saj mund të vazhdojë prej Nishit përmes luginës së Timokut në Kladovë dhe të dalë në portet e Detit të zi. Një krah tjetër duke nisur nga Kumanova mund të lidhet me Qustendillin dhe linjën për Sofje dhe me të lidhet Deti i Zi me Adriatikon e Mesdheun.

Kjo vijë e hekurudhës sipas konfiguracionit natyror, do të ishte më pak problematike nga të gjitha projektet e paraqitura dhe ka përparësi se kalon nëpër gjithë Ballkanin dhe lidh qendrat më të pasura të tij. Manastiri do të ishte një nyje e shkëlqyeshme e hekurudhave si ç'është Budapeshti për Hungarinë. Gjithashtu do të lidhej Adriatiku me Detin e zi, Egjeun, Danubin, me Greqinë, Serbinë, Bullgarinë, Rumaninë; më shumë se ç'do projek tjetër do të kontribuonte për një zhvillim të mirëfillt të Ballkanit. Asnjë nga popujt ballkanikë nuk do të ishte dominant ndaj të tjerëve dhe për të gjithë kjo hekurudhë do të ishte e favorshme.

⁶ Mendohet në kundërshtimin e fortë që shqiptarët kishin për realizimin e projektit austriak, hekurudhës Uvac-Mitrovicë, në pjesën e parë të vitit 1908.

⁷ Mendohet për Kanalin e La Manshit, largësia mes Ostendes në bregun evropian dhe Doverit në bregun anglez.

Kjo hekurudhë në të njëjtën kohë do t'i plotësonte edhe intereset e Shteteve Perëndimore dhe do të pengonte që Austro-Hungaria dhe Gjermania të shtinin nën kontroll rrjetin hekurudhor të Turqisë Evropiane. Kjo atyre do tu mundësonte një lidhje të re komunikimi me Levantin dhe Lindjen e Largët; kjo hekurudhë e lidhur në këtë mënyrë gjithashtu do të shkurtonte rrugën ujore drejt kanalit të Suezit .

Për të gjitha këto arsye që përmendëm, ne besojmë se hekurudha Vlorë Manastir duhet të jetë më e preferueshmja prej gjitha tjerave.